



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 152, Datë 17.07.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“KËLCYRA 2020” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2038/1 prot., datë 11.07.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “KËLCYRA 2020” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2038 prot., datë 08.07.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyrë”, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Klisyrë, Tropojë.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b dhe d).
- Në përputhje me pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (b dhe c).
- Në përputhje me pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (a, b, c, e dhe f).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria “KËLCYRA 2020” sh.p.k. ka në pronësi HEC “Klisyrë”, sipas *Kontratë shitje pasuri e paluajtshme*, nr. 2116 rep., nr. 870 kol., datë 16.12.2020 të nënshkruar me shoqërinë “PETROL ALBA” sha, në cilësinë e shitësit.
- Shoqëria është pajisur me Leje për përdorimin e Burimit Ujor sipërfaqësor nr. 395 prot., datë 11.10.2024, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Drin-Bunë, me nr. Serial000212, e miratuar me Vendim të Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë nr. 17, datë 08.10.2024.
- Shoqëria ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së HEC-it me rrjetin e shpërndarjes përmes shkresës së OSSH sha nr. 1424/3 prot., datë 22.08.2022.
- Me shkresën nr. 110/1 prot., datë 13.01.2021 “*Mbi procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është shprehur se: *bazuar në faktet që aktiviteti është ekzistues dhe ka kryer të gjitha procedurat e privatizimit dhe të blerjes në ankand, por edhe nga pikëpamja mjedisore, nuk kemi shtrirje në zona të reja, ndryshim kuote, prekje të sipërfaqeve të tjera, zgjerime, por vetëm rikonstruksione të lehta në objektin e ndërtuar, si e tillë, ky projekt nuk duhet të nënshtrohet procedurave të VNM-së.*

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën/marrëveshjen përkatëse të shërbimit për financierin e jashtëm.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**
Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “d”** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Vendimin e KBU Drin-Bunë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KËLCYRA 2020” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Klisyra”, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale 2170, nr. pasurie 1071, Tropojë.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “KËLCYRA 2020” sh.p.k, dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI